

**REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE**  
**GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM KORÇË**  
**PËR VITIN 2026**

<b>Nr. Rendor</b>	<b>Data e kërkesës</b>	<b>Objekti i kërkesës</b>	<b>Data e përgjigjes</b>	<b>Përgjigje</b>	<b>Mënyra e përfundimit të kërkesës</b>	<b>Tarifa</b>
1.	14.01.2026	Kërkesë për informacion në të cilën kërkohet, kohezgjatja mesatare të të gjitha gjykimeve të kërkesave për lirim me kusht, të kryera pranë kësaj gjykate gjatë vitit 2025. Nga z. A.L	21.01.2026	Referuar të dhënave statistikore të Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore (ICMIS), rezulton se për vitin 2025 janë shqyrtuar gjithsej 46 kërkesa penale me objekt “lirim me kusht”, për të cilat është disponuar me vendim. Kohëzgjatja mesatare e këtyre gjykimeve, nga momenti i depozitimit të kërkesës deri në shpalljen e vendimit, ka qenë 149 ditë.	E plotë	Nuk ka
2.	16.02.2026	Kërkesë për informacion në mbështetje të Ligjit Nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", kërkoj zyrtarisht informacion mbi gjendjen dhe ecurinë e procesit gjyqësor me të	17.02.2026	Në përgjigje të e-mailit tuaj, iu informojmë se kërkesa juaj është e pabazuar, pasi nuk keni asnjë cilësi në këtë çështje (viktimë, i pandehur /person nën hetim).	E refuzuar	Nuk ka

		<p>dhënat e mëposhtme:  Numri i Aktit:  I pandehur: I.T  Konkretisht, kërkoj të më informoni mbi:  Statusin aktual të kësaj çështjeje (nëse është ende në shqyrtim apo ka përfunduar). Datën dhe orën e seancës së radhës të planifikuar. Nëse është dhënë një vendim, kërkoj të më vihet në dispozicion një kopje e dispozitivit të vendimit. Kërkoj që përgjigjja të më dërgohet në rrugë elektronike në adresën time të email-it nga z. P.M</p>		<p>Aktet e një çështjeje gjyqësore, përfshirë statusin e saj si dhe vendimet gjyqësore, përbëjnë të dhëna që u vihen në dispozicion vetëm palëve në proces ose përfaqësuesve të tyre të autorizuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.</p>		
3.	23.02.2026	<p>Në zbatim të nenit 157 të ligjit nr. 35/2016 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e lidhura me to", i ndryshuar, Drejtoria për të Drejtën e Autorit (në vijim DDA) pranë Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit, është institucioni përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e strategjive dhe</p>	26.02.2026	<p>Të nderuar,  Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë pasi u njoh me shkresën me nr. 766/1 prot, datë 20.02.2026, përcjellë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor mbi bazën e kërkesës suaj për informacion, e cila është protokolluar pranë kësaj gjykate me nr. 1349 prot, datë</p>	E plotë	Nuk ka

		<p>politikave të duhura për mbrojtjen, ushtrimin dhe zbatimin e së drejtës së autorit, të drejtave të lidhura me të dhe të drejtave të tjera, në përputhje me detyrimet ndërkombëtare, legjislacionin vendas dhe interesat përkatës kombëtarë të Republikës së Shqipërisë. Më tej, një kompetencë kyçe e DDA është mbledhja e informacioneve të nevojshme, kryerja e studimeve, si dhe konsultimi dhe bashkëpunimi me autoritetet shtetërore, institucionet publike dhe private, përfaqësuesit e mbajtësve të interesuar të të drejtave dhe përdoruesit, me qëllim përmbushjen e detyrave të saj. Në kuadër të procesit të integritetit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, DDA merr pjesë dhe kontribuon rregullisht në</p>	<p>23.02.2026, ju informon se, nga verifikimi i kryer, nuk rezulton të jetë regjistruar apo shqyrtuar asnjë praktikë gjyqësore (precedent civil, penal dhe administrativ) në fushën e të drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura me të.</p>		
--	--	---	---	--	--

		<p>përmbushjen e detyrimeve për përafrimin e legjislacionit vendas me acquis të BE-së, si dhe në zbatimin e masave të parashikuara nga piketat mbyllëse të përcaktuara nga Komisioni Evropian për Kapitullin 7 "Pronësia Intelektuale", nënkaptullin "E drejta e autorit dhe të drejtat e lidhura". Gjithashtu, një nga detyrimet që vjen nga ky proces është ndërtimi i kapaciteteve ndërinstitucionale dhe krijimi i një "track record" me të dhëna mbi zbatueshmërinë e të drejtës së Ti dërgove autorit dhe të drejtave të lidhura, përsa i përket masave civile, penale dhe administrative në rastet e procedimeve gjyqësore ose procedurave administrative. Për sa më sipër, dhe duke pasur parasysh rolin e Këshillit të Lartë</p>				
--	--	---	--	--	--	--

		<p>Gjyqësor si organi kryesor i qeverisjes së gjyqësorit, me kompetenca në planifikimin strategjik, monitorimin dhe përmirësimin e funksionimit të sistemit gjyqësor, ju drejtohem me kërkesën për vënie në dispozicion të informacionit mbi praktikën gjyqësore (precedentin civil, penal dhe administrativ) në fushën e të drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura me të, me qëllim krijimin e një baze të dhënash referuese për analiza, studime dhe përdorim institucional. Në përfundim, theksojmë se informacioni i kërkuar do të përdoret ekskluzivisht për qëllime institucionale, analitike dhe statistikore, në përputhje me ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit dhe ligjin nr.</p>				
--	--	--	--	--	--	--

		124/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", duke respektuar parimin e ligjshmërisë dhe proporcionalitetit, si dhe pa cenuar të dhënat personale ose informacione të tjera të mbrojtura nga legjislacioni në fuqi.				
4.	24.02.2026	Instituti i Studimeve Politike (ISP), në kuadër të projektit “Promovimi i Llogaridhënies së Zyrtarëve të Zgjedhur 2025–2027” (mbështetur nga NED), po monitoron transparencën dhe standardet procedurale të proceseve të emërimit/zgjedhjes së zyrtarëve të lartë. Në këtë kuadër, bazuar në Ligjin nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, kërkojmë vënien në dispozicion të informacionit të mëposhtëm, lidhur me funksionimin administrativ dhe organizativ të gjykatës suaj: - Organika e	06.03.2026	Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, iu informojmë si më poshtë: 1. Organika e miratuar e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë dhe numri i gjyqtarëve të parashikuar është 15 gjyqtarë. 2. Numri aktual i gjyqtarëve në detyrë është 11 gjyqtarë. 3. Numri i vendeve vakante është 4 gjyqtarë. 4. Shkaqet e vakancave lidhen me 2 shkarkime dhe 2 transferime. 5. Gjatë periudhës 01.09.2025 e në vijim	E plotë	Nuk ka

		<p>miratuar e gjykatës dhe numri i gjyqtarëve të parashikuar; - Numri aktual i gjyqtarëve në detyrë; - Numri i vendeve vakante dhe data e krijimit të secilës vakancë; - Shkaqet e vakancave (p.sh. përfundim mandati, dorëheqje, shkarkim, rivlerësim kalimtar, masa administrative); Nëse, gjatë periudhës 01.09.2025 – në vijim, janë marrë masa administrative (pezullim nga detyra, largim nga sistemi, përfundim mandati ose mosvazhdim ushtrimi funksioni) ndaj gjyqtarëve, si pasojë e: - proceseve të rivlerësimit kalimtar; - zbatimit të Ligjit nr. 138/2015. Për secilin rast (nëse ka), kërkojmë informacion vetëm mbi: - funksionin; - llojin e masës administrative; - datën e vendimit; - organin kompetent vendimmarrës. Nga znj.J.B</p>		<p>janë shkarkuar me vendim të formës së prerë nga Kolegji i Posaçëm i Apelit 2 gjyqtarë, (vendimi nr. 76/2025 (JR) datë 29.10.2025 dhe vendimi nr. 15/2026 (JR) datë 11.02.2026).</p>		
--	--	---	--	--	--	--